

Festa e shkollave 2023
1P dhe 2P
E mërkurë, 28 qershor, në mëngjes

INFORMACIONE PËR PRINDËRIT E NXËNËSVE TË KLASAVE 1P DHE 2P

Përpara festës

Gjatë qershorit, ju do të merrni në çantën e nxënësit, një fletëpalosje me informacione për festën *(për t'u shkarkuar në fund të faqes)*.

Në këtë fletëpalosje, mësuesi/-ja/-it ka shënuar orën në të cilën ju duhet të dorëzoni fëmijën/-ët tuaj në shkollë të mërkurën në mëngjes. Lutemi të jeni të përpiktë, sepse autobusët duhet të nisen në kohë drejt vendit të festës.



Fëmijët nuk duhet të sillen drejtpërdrejt në parkun e Bastions. Ata duhet të nisen nga shkolla së bashku me mësuesin/-en/-it e tyre.

Dita e festës

Parku i Bastions i rezervohet nxënësve të klasave 1P dhe 2P nga ora 09:00 deri në 11:30

3300 nxënësit e klasave të 1P dhe 2P, të shoqëruar prej mësuesit/-es së tyre, shkojnë pa parakaluar në parkun e Bastions. Ata nisen në orën 8:30 prej shkollës së tyre në autobus të rezervuar ose në këmbë për shkollat fqinje. Ata përfitojnë nga karuselet dhe spektaklet prej orës 09:00 deri në orën 11:30, përpara se të kthehen në institucionin e tyre, gjithmonë me transport publik ose në këmbë. **Prindërit vijnë t'i marrin në shkollën e tyre, duke nisur nga mesdita. Ata lirohen pasdite.**



Në rast dyshimi për kohën, ju mund të telefononi në numrin 0900 1600 00 (0,90 CHF/telefonatë dhe 0,90 CHF/min), prej të martës 27 qershor, ora 17:00 deri të mërkurën, 28 qershor, ora 08:00.

Nëse moti është i keq, festa në park do të anulohet.

Lutemi që tani e tutje të kontaktoni shkollën e fëmijës tuaj për t'u njohur me modalitetet e organizimit.

Informacione shtesë

Shërbimi i shkollave dhe institucioneve për fëmijë
022.418.48.00
fetedesecoles@ville-ge.ch